



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

mbledhjen e **tretë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **28.3.2025** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. “UÇK”, nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancës së parë dhe të dytë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve;
3. Diskutim mbi gjendjen e stadiumit të futbollit në Barilevë;
4. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar artistit Faruk Begolli;
5. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar dëshmorëve: Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi;
6. Propozim-vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
7. Propozim-vendimi për definimin e kufirit në mes bllokut A6 dhe A7 të Planit rregullues “Prishtina e Re– Zona Qendër”;
8. Rekomandim për Kryetarin e Komunës së Prishtinës lidhur me respektimin e akteve që dalin nga Kuvendi i Komunës;
9. Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues - Çagllavicë;
10. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor – 30 dhjetor 2024 (TM4);
11. Raport financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024;
12. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
13. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;

14. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, nr- 01-020/05-69249/23, dt. 3.4.2023;
15. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
16. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës;
17. Pyetje dhe përgjigje;
18. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-60/01-38358/25, më 17.3.2025

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

